



# **Pakti për Zhvillimin e Futbollit në Shkodër 2023 - 2027**

Shkodër, Maj 2023



*Të dashur qytetarë të Bashkisë Shkodër,  
Të nderuar kandidatë për Kryetar të  
Bashkisë Shkoder,*

*Duke qënë se më 14 Maj 2023, të gjithë qytetarët shqiptarë do të votojnë për të zgjedhur drejtuesit e rinj të pushtetit lokal, dua t'ju drejtohem me një mesazh shumë të rëndësishëm. Si një qytetar i Bashkisë Shkodër, si një biznesmen që vepron në disa fusha të ndryshme, në mjekësi, ndërtim, shitje me shumicë në rajon dhe më gjërë, ku kompanitë e mëja japin kontribut në zhvillimin e ekonomisë dhe për një shoqëri më të mirë; si kontribues i drejtëpërdrejtë në financimin e sportit në Shkodër, fillimisht atij të basketbollit dhe tashmë të futbollit duke drejtuar Klubin ma të dashtun dhe krenarinë e çdo shkodrani VLLAZNINË e zemrës, dëshiroj t'ju drejtohem me këtë shkresë për të marrë me gjithë seriozitetin e mundshëm vëmendjen tuaj në zhvillimin e sportit në përgjithësi dhe futbollit në veçanti, si një pjesë të rëndësishme të axhendës suaj katër vjeçare!*

*Ju sjell në vëmendje se prej dy vitesh nëpërmjet një menaxhimi dhe financimi krejtësisht privat arritëm ta rikthejmë Vllazninë drejt suksesit, duke e bërë një realitet të prekshëm, që secili prej jush e ka përjetuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë!*

*Për dy vite me radhë fituam dy kupa Republike si dhe rikthyem Vllazninë në kompeticionet evropiane, duke kaluar edhe turnet e para, që i sollën qytetit të Shkodrës një tjetër marketing me ndikim direkt në gjallërimin e bizneseve lokale dhe turizmit!*

*Sot taksapaguesit shkodranë nuk kanë më barrën e rëndë financiare për të paguar një ekip që nën administrimin publik kishte problematika që tashmë të gjithë i dimë si dhe rezultate sportive që e kanë bërë çdo shkodran të ndihet i turpëruar!*

*Por kjo nuk do të thotë që pushteti lokal duhet të harrojë sportin apo ta braktisë në veçanti futbollin! Gjatë vitit të kaluar ne jemi drejtuar disa herë Bashkisë Shkodër, konkretisht kryetarit të Bashkisë, për mundësinë direkte të bashkëpunimit nëpërmjet mbështetjes me fonde prej programit reload, për zhvillimin e infrastruktures, etj.*

*Në projektin tonë e kemi të domosdoshme partneritetin me qeverisjen vendore për masivizimin e futbollit, për përfshirjen sa më të gjërë të fëmijëve si në zonat urbane, rurale apo edhe ato turistike!*

*Ne kemi nevojë që t'i jepet çdokujt mundësia që të luajë, të angazhohet apo të përfitojë nga frytet e sportit të futbollit nën moton "Futboll për të gjithë" dhe ta rikthejmë qytetin tonë të dashur, aty ku futbollit foli shqip për herë të parë, në një qendër rajonale të zhvillimit të talenteve të reja apo të garave rajonale të këtij sporti aq të dashur për të gjithë ne.*

*Me bashkëpunimin e të gjithë aktorëve lokalë, pushtetit vendor dhe atij qëndror, Federatën Shqiptare të Futbollit, organizmat ndërkombëtare, besimin tek i madhi Zot, me përkushtim, punë, vullnet dhe pasion, do të arrijmë tek suksesi i merituar.*

*Prandaj duke ju uruar mbarësi në fushatën tuaj zgjedhore dhe me dëshirën e madhe që të krijojmë një bashkëpunim sa më të ngushtë me institucionin e Bashkisë Shkodër, Kryetarin e Bashkisë dhe Këshillin Bashkiak, ju ftoj që të nënshkruajmë "Paktin për Zhvillimin e Futbollit në Shkodër"*

*Alban Xhaferi*

*President KF Vllaznia*

## **PAKTI PER ZHVILLIMIN E FUTBOLLIT NE SHKODER**

### **1. Gjithpërfshirja dhe masivizimi në futboll:**

- Shndërrimi i ditëlindjes së Vllaznisë, datës 16 shkurt, në një datë ku të organizohen manifestime sportive: konferenca me donatorë të ndryshëm, turne futbollit, aktivitete kulturore dhe rekreative, duke e kthyer këtë datë në një simbol të krijimit të partneriteteve të reja në funksion të zhvillimit të futbollit.
- Bashkia Shkodër në bashkëpunim me Federatën Shqiptare të Futbollit, Shoqaten Rajonale të Futbollit, Klubin e Futbollit Vllaznia dhe partnerë të tjerë potencial, do të asistojë ndërmjet ofrimit të tokës falas për ndërtimin e një kompleksi sportiv, hotelerie dhe shërbimesh ku përfshihen minimumi 5 deri në 10 fusha sportive sintetike dhe me bar natyral, të cilat do të shërbejnë për organizimin e kampionateve mes shkollave, kampionate mes lagjesh apo edhe si ambjente stërvitjeje për ekipet e Akademisë së Futbollit Vllaznia të djemve dhe të vajzave dhe ekipet e para. Ky projekt duhet të fillohet të implementohet brenda vitit 2023-2024

### **2. Edukimi i brezit të ri për futbollin:**

- Bashkia Shkodër do të kryejë rivitalizimin e shkollës sportive "Xheladin Fishta", njëres prej shkollave të para të sportit në Shqipëri ku janë rritur dhe zhvilluar talente si: Ramazan

Rragami, duke krijuar ambiente dhe terrene sportive në funksion të kësaj shkolle për edukimin e brezave dhe talenteve të reja.

- Në këtë shkollë duhet të krijohen kushtet e nevojshme për të edukuar brezin e ri, djem dhe vajza drejt gjithëpërfshirjes në sportin e luajtur të futbollit apo aftësimin e tyre në kryerjen e funksioneve ndihmëse, siç mund të jenë statisticien, skautë, videoanalistë, data analist, etj.

### **3. Ndërtimi i qendrës rajonale të trajnimit sportiv:**

- Rikonceptimi i Fushës sportive “Reshit Rusi” ku të parashikohet ndërtimi i ambienteve akomoduese, me trajtim ushqimor për djemtë dhe vajzat që vijnë nga zonat rurale dhe që kanë dëshirë të ndjekin programet arsimore të sportit.
- Ndërtimi i një qendre burimore dhe të kërkimit shkencor sportiv, ku të përpunohen të dhënat statistikore, programet e trajnimit, programet e kualifikimit të trajnerëve.
- Ndërtimi i sallave të forcës për ekipet e akademisë.

### **4. Kthimi i Stadiumit “Loro Boriçi” në një qendër të madhe sportive:**

- Dhënia në përdorim afatgjatë për KF Vllaznia të Stadiumit “Loro Boriçi” ,brenda vitit 2023 ,sipas ligjit për dhënien në përdorim të aseteve shtetërore për një periudhë 35 vjeçare, ku klubi I Futbollit Vllaznia ne bashkepunim me Federaten Shqiptare te Futbollit dhe partnere te tjere, do te prezantoje nje plan mirembatje te vazhdueshme dhe investimesh per venien ne eficence te plote te te gjithë strukturave te ketij impianti ne funksion te klubit dhe me gjere ku cilesohet :
- Ndërtimi pranë këtij stadiumi i klinikës së parë fizioterapike, ku mund trajtohen me shërbime të specializuara jo vetëm sportistët, por edhe banorët e qytetit.
- Ndërtimi i sallave të forcës për ekipet e para dhe rigjallërimi i ambienteve të stadiumit në funksion të KF Vllaznisë.
- Krijimi i hapësirave funksionale për zhvillimin e aktiviteteve sociale, kulturore dhe rekreative.
- Krijimi i hapësirave funksionale të parkingut në funksion të stadiumit.

### **5. Buxhet i dedikuar dhe lehtësi fiskale**

- Krijimi i lehtësive fiskale si dhe ofrimi i partneritetit nga Bashkia Shkodër nëpërmjet një fondi për zhvillimin e sportit (programet reload), me një përqindje të caktuar vjetore, për të investuar në infrastrukturën sportive apo projekte që kanë të bëjnë me zhvillimin e futbollit të djemve dhe vajzave

### **6. Krijimi i një platforme online për mbështetjen e futbollit:**

- Në faqen e Bashkisë Shkodër të krijohet një platformë online ku të përfshihen biznese, partnerë dhe donatorë të ndryshëm, të cilët informohen në lidhje me aktivitetet sportive.

**Nënshkruar nga:**

**Kandidati për Kryetar Bashkie:**

**Nënshkruar nga:**

**Presidenti i KF Vllaznia**

**Alban Xhaferi**